



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN TIRANË

Nr. 1252/prot
2

Dt. 08/03/2018

VENDIM
Nr. 7 Dt. 20.02.2018

PËR

MIRATIMIM TË KËRKESËS PËR PAJISJE ME LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, PËR AMBALLAZHIM SHISHE OSE ENË, NË BURIMIN GURRA E MILAJT FSHATI SHËNGJIN, BASHKIA TIRANË SUBJEKTI “AISHE LUZI”

Në Zbatim të Ligjit Nr.111/2012 Datë 15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht N. 41 pika 1 Gërma “d”, dhe N.50 pika 2; Vendimin Nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor” Neni 7 pika 3, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores, “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor” Neni 11 pika 3, vendimit nr.6 datë 14.12.2017 “Për Shqyrtimin e kërkesës për pajisje me leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor, për amballazhim shishe ose enë në burimin Gurra e Milajt, fshati Shëngjin, Bashkia Tiranë, Subjekti ‘Aishe Luzi’,

KËSHILLI I BASENIT UJOR,

Shqyrtoi dokumentacionin nga subjekti “Aishe Luzi” dorëzuar me kërkesën datë 07.02.2018 sipas vendimit nr 6 datë 14.12.2017 të KBU Ishëm-Erzen në bazë të cilit KBU Ishëm –Erzen vendosi ; “Rrëzimin e Kërkesës për pajisje me leje të përdorimit të burimit ujor për amballazhim shishe ose enë në burimin Gura e Milajt” dhe për tu pajisur me leje të përdorimit të burimit ujor subjekti duhet të plotësonte kushtet e mëposhtme:

- Të merret opinioni i Ujësjellës Kanalizime Tiranë për prioritetin e ujit të pijshëm për këtë burim ujor.
- Të merret opinioni i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Pëërsëritjen të analizave për ujin e pijshëm.
- Heqja nga fondi pyjor.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur, Këshilli i basenit Ujor Ishëm-Erzen,

KONTATON SE,

1. Subjekti Aishe Luzi ka paraqitur dokumentacionin konform vendimit Nr,6 datë 14.12.2017 të KBU Ishëm Erzen
2. Është plotësuar dokumentacioni në lidhje me opinionin e Ujësjiellës Kanalizime për prioritetin e ujit të pijshëm. Me shkresën Nr.384/1 datë 22.01.2018, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë shpreh dakortësinë e dhënies së lejes, por të operohet me subjektin “Aishe Luzi”për marrjen e sasisë për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatit Shëngjin prej 1 l/s nga ana e UKT-së në zbatim të nenit 55 të ligjit 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”
3. Marrja e opinionit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në zbatim të kësaj pike AKZM me shkresën nr.12/2 prot datë 06.02.2018 shprehen se kjo veprimtari mund të zhvillohet vetëm pasi subjekti të pajiset me lejet përkatëse.
4. Përsëritja e analizave të ujit të pijshëm.Analizat janë kryer nga laborator i privat “ECCAT”shpk, laborator i cili është i akredituar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes. Gjithashtu subjekti me shkresën Nr.25 prot datë 10.01.2018 i është drejtuar Institutit të Shëndetit Publik “për bërjen e analizave total të ujit, nuk është njoftuar ende për tu paraqitur për kryerjen e analizave.
5. Heqja nga fondi Pyjor, në zbatim të kësaj pike Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit me shkresën nr.58/1 datë 18.01.2018 shprehet ndër të tjera se: “për heqjen nga fondi pyjor është e nevojshme, leja e aktivitetit e miratuar nga enti përkatës” në këtë rast kërkohet miratimi i lejes së përdorimit të burimit ujor nga KBU.

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen,

V E N D O S I:

1.Miratimim e kërkesës për pajisje me leje përdorimi të burimit ujor nëntokësor, për ambalazhim shishe ose enë, në burimin “Gurra e Milajt”, për subjektin “AISHE LUZI ” me administrator Aishe Luzi, vendodhja Fshati Shëngjin, bashkia Tiranë, pa cënuar rezervën e lirë të popullatës.

Koordinatat e Burimi “Gurra e Milajt” **X= 44 21 510 Y=45 75 410 Z= 728 m**

a.Prurja mesatare e vjetore **q=0.007-0.009 m³/s (7-9l/s)**

b. Sasia e ujit që kërkohet **q=0.005 m³/s**

c. Rrjedha Ekologjike **q=0.0015 m³/s**

ç.Sasia e ujit që do jepet në përdorim **Q= 0.004 m³/s (4l/s)**

2. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoffimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Shpëtim MEDIU



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

